



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 826 Prot.

Tiranë, më datë 07.07.2022

VENDIM
Nr. 382, datë 07.07.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 *“Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”*, pas shqyrtimit më parë të aplikimit *“Restaurim adaptim i banesës 2 kate në shtrukturë akomoduesë BB”*, Brenda kufirit Zona arkeologjike “A”, Krujë, me aplikues Piro Karanzha dhe zhvillues Fatos Hoxha në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 07.07.2022:

VENDOSI:

1. Aplikimi i sipërcituar, për arsye të mospërmbytjes në të, të ndërhyrjeve për vlerësim referuar VKM nr. 427, datë 20.6.2012 *“Për Shpalljen e Zonave Arkeologjike “A” dhe “B” të Qytetit të Krujës dhe Miratimin e Rregullores së Administrimit”*, gjykohet e arsyeshme se nuk ka elementë për vendimmarrje lidhur me to;
2. Monitorimin nga DRTK Tiranë, për çdo ndërhyrje, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

